



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 23, datë 13.07.2020

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES FINANCIARE DHE TË SHPËRNDARJES SË TË
ARDHURAVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; dhe pasi shqyrtoi rregulloren e paraqitur nga Administratorja e UART, Znj. Alma Sinanaj dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores financiare dhe të shpërndarjes së të ardhurave në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashklidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratorja e Universitetit të Arteve.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Risena Xhaja (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorenc Vangjeli (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE
FINANCIARE DHE E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE
E
UNIVERSITETIT E ARTEVE

Miratur me Vendim _____ datë _____, të Bordit të Administrimit



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

BAZA LIGJORE

Kjo rregullore hartohet, bazuar në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë ne Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, gërma c, neni 49, pika 1, gërma e dhe ë, dhe neni 109, pika 2 dhe 3.

NENI 2

OBJEKTI

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave të krijuara nga universiteti, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit.

NENI 3

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i të ardhurave të institucionit, si dhe shmangia e përdorimit apo keqpërdorimit të tyre.

NENI 4

TË ARDHURAT E INSITUCIONIT

1. Bazuar në nenin 108 dhe 109, të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë ne Republikën e Shqipërisë”, të ardhurat e krijuara nga institucioni janë një prej burimeve të financimit të tij. Ato përdoren tërësisht prej vetë institucionit dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës.
2. Në të ardhurat që mund të krijohen nga insitucioni përfshihen:
 - Pagesat e studentëve për konkurim, regjistrim dhe tarifë shkollimi;
 - Të ardhurat për shërbimet e kryera;
 - Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
 - Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
 - Veprimtari kërkimore – shkencore.



KREU II

PËRDORIMI I TË ARDHURAVE

NENI 5

PARIMET

Përdorimi i fondeve të krijuara nga të ardhurat e institucionit bëhet duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë së veprimeve dhe procedurave, si dhe ekuilibrin ekonomik dhe financiar.

NENI 6

KRITERET

Kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet mënyra e ndarjes dhe përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, janë si vijon:

- Numri i studentëve për çdo njësi;
- Numri i pedagogëve me tituj e grada;
- Parimi i përfitimit të të ardhurave që gjëneron çdo njësi;

NENI 7

MËNYRA E PËRDORIMIT

1. Mënyra e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në nenin 4, pika 2, të kësaj rregulloreje bëhet çdo vit në varësi të nevojave të institucionit për investime, shpenzime operative, paga, kërkim shkencor etj.
2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shpencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe insitucionit, si më poshtë vijon:
 - a) Të ardhura të përfituara nga **shërbimet e kryera** të ndahen në masën 40% personeli akademik dhe 60% insitucioni.
 - b) Të ardhura të përfituara nga **veprimtaria kërkimore – shkencore** të ndahen në masën 20% personeli akademik dhe 80% insitucioni.
 - c) Të ardhura të përfituara nga **konsulencat** të ndahen në masën 20% personeli akademik dhe 80 % insitucioni.
 - d) Të ardhura të tjera të përfituara nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik të ndahen rast pas rasti me vendim të veçantë të Bordit të Administrimit, duke pasur parasysh parimin e kostove dhe përfitimeve të realizuara.
 - e) Për të ardhurat e përmendura në gërmat a,b dhe c më sipër, me vendim të Bordit të Administrimit mund të vendoset me ndarje tjetër nga ajo e përcaktuar në këto gërma, me iniciativën e tij ose ku bëhet kërkesë nga personeli përkatës akademik dhe/apo administrator i insitucionit si përfaqësues ligjor për çështjet financiare dhe



administrative, vetëm pasi të paraqiten argumenta bindëse që tregojnë pamundësinë e ndarjes së të ardhurave sipas përcaktimeve përkatëse në gërmat a,b dhe c.

NENI 8

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Strukturat përgjegjëse për propozimet, kërkesat për financime të njësive kryesore, miratimin, menaxhimin dhe kontrollin, si dhe ekzekutimin e veprimeve përkatëse ekonomiko-financiare dhe të kontabilitetit, lidhur me përdorimin e fondeve të krijuara nga të ardhurat, sipas detyrave në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në aktet e tjera përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi, në Statutin e Universitetit, si dhe në Rregulloren e Universitetit janë si më poshtë vijon:

- Senati Akademik;
- Bordi i Administrimit;
- Rektorati;
- Dekanatet;
- Admistratori i insitucionit;

KREU III

DISPOZITA E FUNDIT

NENI 9

Në çdo rast, për mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, insitucioni bazohet në Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin përkatës për buxhetin, aktet e tjera përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi, në Statutin e Universitetit, si dhe në këtë rregullore.

NENI 10

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Administrimit i institucionit.

MIRATUAR

BORDI I ADMINISTRIMIT